



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2021:287611

Datë: 19.03.2025

Numri i dokumentit: 07013853

C.nr.1826/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin Skender Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.K. , të cilin sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson avokat Sheremet Ademi dhe Leutrim Ademi, më seli në Mitrovicë, kundër të paditurës KM - DKA të cilin sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson avokat Lirim Zeka, më seli në Prishtinë, me objekt kontesti “*Kompensim i të ardhurave nga marrëdhënia e punës*”, me vlerë të kontestit prej 698.19 euro, jashtë seance gjyqësore, më datën 19.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit M.K. nga Mitrovica me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura KM - DKA që në emër të diferencës në të ardhura personale për kualifikim për periudhën kohore nga 01.10.2020 e deri me 30.10.2023, për 37 muaj, me diferencë prej 18.87 euro në muaj, t’ia paguaj paditësit shumën në total prej 698.19 euro me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e parashtrimit të padisë me 21.12.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plothuqshmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 21.12.2021, ka paraqitur padi, të precizuar me dt. 04.12.2023 në këtë gjykatë, kundër të paditurës, me objekt të kontestit në emër të diferencës në të ardhura personale për kualifikim, me vlerë të kontestit 698.19 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë deri në pagesën definitive, si dhe t’i kompensoi shpenzimet e procedurës.

Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune në shkollën e mesme ekonomike “Hasan Prishtina” në pozitën profesor. Ka shtuar se me në kontratën e punës i njëjti figuron si Bachelor i Juridikut e që është në kundërshtim me UA nr.02/2017, të MASHT, neni 3, par.1 lidhur me nenin 7, par.1, dispozita që kanë të bëjnë me trajtimin e barabarte ligjor të gjithë të të diplomuarëve në programet studimore të (ri) licensuara dhe ri akredituara, të cilët konsiderohen të barabartë me të diplomuarit në Institucione Publike.

Paditësi ka pa përgatitjen shkollore “Master i shkencave juridike penale”.

Bazuar në nenin 3, par.1 lidhur me nenin 7, par.1 të këtij Udhëzimi, ka theksuar se është përcaktuar që diferenca në pagë sipas gradës së paditësit prej 18.87 euro për periudhën 01.10.2020 deri me 30.10.2023, për 37 muaj x 18.87 euro, duhet të paguhet në shumën prej 698.19 euro, ndërsa sipas pretendimeve të paditësit rezulton që kjo shumë nuk është realizuar nga e paditura. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta detyrojë të paditurën që në emër në emër të diferencës në të ardhura personale për kualifikim (Master i shkencave Juridike Penale), për periudhën 01.10.2020 deri me dt. 30.10.2023, për 37 muaj muaj t’ia paguaj diferencën në shumën prej 698.19€, si dhe kamatë ligjore në shumë prej 8% nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, fillimisht vërejtë se padia është përpiluar në tërësi në përputhje me dispozitën nga neni 253, lidhur me nenin 99 të LPK, pas plotësimit të kushteve ligjore, të njëjtën (padinë me dokumentet e bashkangjitura në të), më Aktvendimin që mbanë shenjen C.nr.1826/2023, të datës 13.01.2025, e detyron të paditurën që në afatin prej 15 ditësh të paraqesë përgjigje në padi, nën kërcënimin e pasojave juridike.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pabaz.01/33 të datës 29.08.2008 ka përcaktuar se “*Ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesionalë në nivelin fillor dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licensimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës.*” Rrjedhimisht duke u bazuar në dispozitën e lartpërmendur kompensimi i cili u njihet mësimdhënësve kushtëzohet me kriteret e licensimit. Pra kjo nënkupton që mësimdhënësit do të përfitojnë në shtesat në pagë në emër të kualifikimit nëse të njëjtit do të licensohen duke u pajisur me licenca ashtu siç është rregulluar me anë të akteve nënligjore MASHT-it. Paditësja nuk ka bashkëngjitur asnjë licensë për të vërtetuar se është e licensuar duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 1

i LPK-së i cili përcakton se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*

Tutje, e paditura shton se padia e paditësit është e palejuar si rezultat i faktit që nuk i ka bashkëngjitur provat e lartëcekura si dhe ngaqë paditësi ka parashtruar padinë drejtpërdrejtë në gjykatë pa iu drejtuar punëdhënësit paraprakisht me kërkesë konform nenit 78 të Ligjit të Punës cili përcakton se *“I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura”.*

Më pas e paditura pretendon kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe i mungon baza juridike, ngaqë ky i fundit kërkesëpadinë e tij e bazon në Vendimin Nr.01/33 të datës 29.08.2008, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, tutje referuar si *“Vendimi i Qeverisë”*, i cili vendim është shfuqizuar me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit për pagat në Sektorin Publik.

Gjithashtu e paditura konsideron se paditësi nuk ka legjitimitet pasiv në këtë procedurë mbështetur në Vendimin Nr.01/33 të datës 29.08.2008 në pikën 1 të këtij vendimi ka përcaktuar që *“Nga 1 Shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorë (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave në bazë të kriterëve të licensimit”*, ndërsa në pikën 8 të këtij vendimi ka përcaktuar që *“Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike”*. Rrjedhimisht, për zbatimin e këtij vendimi nuk janë të obliguar komunitat e Republikës së Kosovës. Prandaj, e paditura nuk ka legjitimitet pasiv në këtë rast, pasi që ky Vendim nuk e obligon të paditurën. Andaj mbi bazën e këtyre të dhënave i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: diploma universitare e datës 29.09.2020, kërkesa e datës 08.11.2021, transaksionet bankare për periudhën kohore 01.10.2021 deri 31.10.2021.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura në kuptim të nenit dhe 399 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e

aktgjykimit jashtë seance ashtu që me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e papabuar.

Gjykata gjatë analizimit të të kërkesës së paditësit në këtë çështje kontestimore në emër të kompensimit të pagave shtesë në emër të licencimit vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shkak se paditësi nuk ka bashkëngjitur Licensën e Karrierës e lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Kjo bazuar në dispozitën e nenit 7 paragrafi 1 të LPK, ku shprehimisht thuhet *“Palët kanë për detyre të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohet faktet e tilla”*, ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1 dhe 2, të po të njëjtit ligj shprehimisht thuhet *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, ku të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit”*.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi konform mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numer GJ.A. Su.A 214/2023 të dates 09.10.2023, në të cilën lidhur kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licensimit), sipas inflacionit dhe periudha kohore në të cilën zbatohet Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.105, datë 22.02.2021. Në pikën I të këtij mendimi Juridik është përcaktuar që *“Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licensimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008.*

Qeveria e Republikës së Kosovës me anë të Vendimit Nr.01/33 të datës 29.08.2008 në pikën 1 të këtij vendimi ka përcaktuar se *“Nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesionalë në Shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje në bazë të krierve të licensimit”*, kurse në pikën 8 të këtij vendimi është përcaktuar që *“Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike”*.

Andaj, gjykata vlerëson se nga të lartëcekurat rezulton që e paditura Komuna e Mitrovicës – Drjetoria Komunale e Arsimit nuk është e obliguar të ia kompensoj paditësit shumë e kërkuar si në kërkesëpadi, pasi që për këtë kompetente do të duhej të ishte Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike.

Në lidhje më afatin për ankesë prej 7 ditësh, Gjykata vendosi në bazë të nenit 476 dhe 477 të LPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 450, lidhur me nenin 463 paragrafi 1 të LPK, ashtu që pala paditëse nuk e ka fituar kontestin, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, ashtu që gjykata vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lartëcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 7.1, 319 par.1 dhe 2, dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.1826/2023, datë 19.03.2025

GJYQTARI

Skender Shala

*UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese ne afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.*